




**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
Autoritet za Konkurrenciju - Competition Authority



**Vendimi Nr.100/23**  
**Datë: 20.11.2023**

Duke u bazuar në nenin 11 par.1, nenet 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 par 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, në mbledhjen e datës: 20.11.2023, mori këtë:

## V E N D I M

- I.** Lejohet - Përqendrimi i ndërmarrjeve, lidhur me krijimin e një Ndërmarrje të Përbashkët JV (joint venture) me funksion të plotë, nga Rockaway Group a.s., dhe KKCG Real Estate Group a.s.
- II.** Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja gjashtë mijë Euro.

### Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 12.10.2023 ka pranuar kërkesën për Përqendrim, më Nr. Prot. 480/23-01/H, lidhur me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët JV (joint venture) me funksion të plotë nga Rockaway Group a.s. KKCG Real Estate Group a.s.

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 26.10.2023
3. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 30.10.2023

Sipas Dokumentit të Kushteve (Term Sheet), i nënshkruar më datë 24 Mars 2023, lidhur me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët (joint venture) me funksion të plotë, palët në përqendrim, janë:

- Rockaway Group a.s., është shoqëri aksionare e themeluar në Republikën Çeke, me numër të regjistrimit të biznesit 07679475, dhe adresë të regjistruar në Evropska 2758/11, Dejvice, 160 00 Prague 6, Republika Çeke. Aktivitetet e Rockaway kanë të bëjë kryesisht me tregtinë elektronike, udhëtimeve elektronike, teknologjitë financiare, mediat dhe botimeve e librave, kapitalin sipërmarrës dhe investimet në zhvillimin e pasurive të paluajtshme. Rockaway Group është aktive

kryesisht përmes subjekteve si më poshtë; Grupi Mall, Grupi Heureka, Grupi Invia, Grupi Euromedia, Rockaway Venture, Gjirafa. Rockaway ushtron kontroll të përbashkët mbi Gjirafa Group me dy palë të tjera, e cila operon me një motor kërkimi në gjuhën shqipe, një platformë marketingu online dhe një platform e-commerce e fokusuar në Republikën e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

- KKCG Real Estate Group a.s., është shoqëri aksionare, me numër të regjistrimit të biznesit 07679475, dhe adresë të regjistruar në Evropska 866/71, Vokovice, 160 00 Prague 6, Republika Çeke, kompania është aktive si zhvillues rezidencial dhe zyresh në Republikën Çeke. I përket Grupit KKCG, i cili është aktiv kryesisht në fushat e mëposhtme; naftë dhe gaz, inxhinieri, lojëra dhe argëtime, teknologji, IT dhe pasuri të paluajtshme. Në Kosovë Grupi KKCG është i pranishëm përmes një filiali, Musala Soft Kosovë L.L.C.

Baza juridike;

Sipas nenit 13, të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që;

- a) Qarkullimi i palëve në Përqendrim, tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
- b) Qarkullimi i njërës palë në Përqendrim, në tregun e brendshëm, kalon shumën 1,000,000 Euro.
- c) Parashtruesit e kërkesës kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen lidhur me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët (joint venture) me funksion të plotë të lidhur me 24 Mars 2023
- d) Kërkesa për përqendrim, është bërë për arsye se Aplikuesit kanë filiale të regjistruar në Republikën e Kosovës.

#### Analiza e Konkurrencës dhe Vlerësimi i Konkurrencës

Transaksioni i propozuar ka të bëjë me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët (joint venture) me funksion të plotë nga KKCG Real Estate Group a.s., dhe Rockaway Group a.s. Parashikohet që JV do të jetë aktive në fushën e shërbimeve të pasurive të paluajtshme brenda BE kryesisht në Republikën Çeke, por potencialisht edhe shtetet tjera anëtare të BE-së, palët nuk ka në planë që JV të jetë aktive në asnjë mënyrë në tregun e Republikës së Kosovës.

Parashikohet që JV të ndahet në dy blloqe funksionale. Blloku i parë të fokusohet në zhvillimin industrial (Blloku Industrial) dhe blloku i dytë do të fokusohet në zhvillimin e banesave dhe zyrave (Blloku Rezidencial-Zyra).

Transaksioni si i tillë nuk do ndikojë në tregun e Kosovës, pra nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës, transaksioni i propozuar nuk mund të forcoj asnjë pozitë dominues në treg, për më tepër, meqenëse targeti nuk ka prezencë, tregu i Kosovës mbetet i pa ndikuar nga ky transaksion.

Tregu përkatës, mbetet i pandryshuar edhe pas transaksionit.

Tregu i produktit, përfshin fushën e shërbimeve të pasurive të paluajtshme, e fokusuar kryesisht në zhvillimin e pronave industrial, të tilla si qendra logjistike, magazinat etj, zhvillimin e zyrave dhe zhvillimin e banesave.

Tregu gjeografik, në transaksionin e propozuar do të jetë territori i Republikës së Çekisë, dhe shteteve të tjera të BE-së dhe si i tillë do të përcaktohet tregu ndërkombëtar.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Çekisë. Kërkesa për Njoftim të Përqendrimit është bërë për arsye se palët kanë degë të regjistruar në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit nga ky transaksion, nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës, për arsye se targeti nuk do e shtrijë aktivitetin e saj në Republikën e Kosovës, pra nuk do të jetë prezent në tregun e Republikës së Kosovës qoftë përmes personit juridik ose nëpërmjet shitjeve dhe si i tillë nuk ka mundësi të bëjë ndryshim në strukturën (horizontale apo vertikale) të tregut, sa i përket mbivendosjeve të mundshme horizontale, përqendrimin i propozuar nuk implikon mbivendosje të konsiderueshme horizontale, kjo pasi palët njoftuese Rockaway dhe KKCG nuk garojnë me njëra tjetrën në përcaktimin e tregut në segmentet ku këto njësi ekonomike, janë aktive.

Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar se transaksioni nuk paraqet efekte negative, në konkurrencë për arsye se ky transaksion /blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominues të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

Shënim: Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti- konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij Vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi  
Kryetare

Kaltrina Sela  
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj  
Anëtare

Florent Mehmeti  
Anëtar

Salihe Gashi-Loku  
Anëtare

PIII. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva